VENDIM
Nr. 156, datë 6.10.2016

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "XHENGO ENERGJI" SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "ç" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 21, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë "Xhengo Energji" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Xhengo Energji" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, germa "a", germa "b" dhe germa "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Xhengo Energji" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti